

Tregjet e punës të Ballkanit Perëndimor nën krizën COVID-19¹

- *Përpara fillimit të krizës COVID-19, Ballkani Perëndimor kishte nivele të larta rekord të punësimit dhe nivele të ulëta rekord të papunësisë.*
- *Kriza COVID-19 ka fshirë tashmë një pjesë të arritjeve në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor: deri në prill 2020, qenë humbur 40 për qind e arritjeve në uljen e papunësisë.*
- *Ndikimi total në punësim pritet të jetë i paprecedent dhe me bazë të gjerë dhe të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë marrë masa për t'i mbështetur ndërmarrjet të ruajnë vendet e punët dhe për të mbrojtur të papunët.*
- *Me fillimin e fazës së rimëkëmbjes, autoritetet të mos e largojnë vëmendjen nga sfidat afatgjata, siç janë mungesat akute të fuqisë punëtore dhe aftësisë dhe produktiviteti i ulët.*

Masat për mbrojtjen e jetës do të kenë ndikim negativ në tregjet e punës në Ballkanin Perëndimor. Kufizimet mbi lëvizjen dhe mbajtja e distancës sociale kanë cenuar ofertën dhe kërkesën e krahut të punës, transportin dhe udhëtimet në mënyrë të paprecedentë. Janë mbyllur sektorë të tërë të ekonomive kombëtare: hoteleri-restorantet, tregtia jo e domosdoshme me pakicë, turizmi, transporti dhe një pjesë e mirë e prodhimit. Pavarësisht nga paketat e mbështetjes shtetërore, bizneset e të gjitha ekonomive po pësojnë humbje, çka rrezikon operacionet dhe aftësinë e tyre paguese. Më të prekura janë firmat e vogla dhe të mesme², si edhe bizneset joformale. Efekti te veprimtaritë që sjellin të ardhura është sidomos i rëndë për punonjësit e pambrojtur dhe grupet më të cenueshme në ekonominë joformale. Tregjet e punës ku vetëpunësimi dhe punësimi joformal dhe i përkohshëm është shpërpjesëtimor kanë të ngjarë të përballen më shumë me humbjen e vendeve të punës, çka do të duhet të trajtohet nëpërmjet sistemeve të mbrojtjes sociale. Opsionet e hollësishme të politikave për të mbështetur të papunët dhe grupet e popullsisë që janë bërë rishtazi të cenueshme, ndërkohë që shfaqen pasojat shoqërore të kësaj krize por edhe gjatë fazës së rimëkëmbjes, mund t'i gjeni në dokumentet shoqëruese të Raportit të Rregullt Ekonomik, sidomos në dokumentin “Kundërpërgjigjet e mbrojtjes sociale ndaj krizës COVID-19 në Ballkanin Perëndimor”.

Kriza COVID-19 e gjeti Ballkanin Perëndimor me nivele të larta rekord punësimi.

Punësimi në Ballkanin Perëndimor arriti nivelin më të lartë historik në vitin 2019 prej 45,6 për qind për grup-moshat 15+, një rritje me 1,4 pikë përqindjeje nga viti 2018. Në fund të vitit, Kosova kishte rritjen më të madhe të numrit të personave të punësuar: 6,7 për qind në normë vjetore. Rritja vjetore e punësimit qe rreth 4 për qind në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi dhe 3,1 për qind në Shqipëri, por në Malin e Zi u ngadalësua në 0,3 për qind në normë vjetore. Në vitin 2019, janë krijuar 190.000 vende të reja pune në Ballkanin Perëndimor, nga të cilat më shumë se një e treta janë krijuar në Serbi. Deri në fund të vitit, niveli i punësimit në rajon qe 7,7 për qind më i lartë se në qershor të vitit 2008, në fillim të krizës së fundit financiare globale, dhe rajoni ka pasur pesë vjet rritjeje të vazhdueshme të punësimit me normë mesatare vjetore prej 2,8 për qind.

Punësimi në rajon qe rritur aq shumë sa që kishte sjellë mungesa të fuqisë punëtore dhe trysni për rritje të pagave. Përpara krizës, mungesa e fuqisë punëtore ka qenë e theksuar në Serbi dhe në Maqedoninë e Veriut në sektorin e prodhimit dhe atë të transportit, ndërsa Mali i Zi kishte mungesa të fuqisë punëtore në turizëm. Gjatë dy viteve të fundit, rritjet e rrogës minimale e kishin rritur rrogën mesatare me mbi 12 për qind. Prej vitit 2017, rrogat bruto të shprehura në euro janë rritur me 25 për një të katërtën në Serbi,

¹ Ky dokument, i përgatitur nga Sanja Madžarević-Šujster, ka përfutur nga komentet e bëra nga Stefanie Brodmann, Marc Schiffbauer, Edith Kikoni, Enrique Blanco Armas, Jasmin Chakeri dhe Gallina Vincelette.

² Shih edhe dokumentin shoqërues: “Cenueshmëria nga COVID-19 në Ballkanin Perëndimor: perspektivë në nivelin e firmave.”

me mbi 21 për qind në Maqedoninë e Veriut, me 18 për qind në Shqipëri dhe rreth 10 për qind në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në Kosovë dhe në Malin e Zi, pagat janë rritur me mbi 2 për qind. Megjithatë Kosova është vendi me rritjen më të madhe të punësimit, ka ende një sasi të madhe fuqie punëtore të pashfrytëzuar ende. Niveli më i lartë i pagës bruto është vërejtur në Malin e Zi, mbi 780 euro, por diferencat sa i takon koston e fuqisë punëtore po ngushtohen: në vitin 2017 rroga bruto në Malin e Zi qe më shumë se dyfishi i rrogës bruto në Shqipëri; tani është 1,8 herë më e lartë.

Shkalla e papunësisë ka rënë në nivele të ulëta rekord në Ballkanin Perëndimor. Në vitin 2019 norma e papunësisë ra në 13,4 për qind, 2,3 pikë përqindjeje më pak se në 2018, ku në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut ra me 3,5 pikë përqindjeje. Në Shqipëri arriti një nivel të ri të ulët prej 11,5 për qind; në Bosnjë dhe Hercegovinë ra në 15,5 për qind. Në tremujorin e fundit të vitit 2019, norma e papunësisë ra edhe më shumë në 12,7 për qind për rajonin në tërësi, dhe arriti një nivel njëshifror në Serbi kur iu afruar edhe më shumë nivelit prej 6,1 për qind në BE. Në vitin 2019, në Ballkanin Perëndimor pati 163.000 më pak të papunë në krahasim me vitin 2018, një e dyta e të cilëve qenë në Serbi dhe 20 për qind e të cilëve qenë të rinj, duke e ulur kështu papunësinë e të rinjve me 4 pikë përqindjeje, në më pak se 29 për qind, që është një nivel i ulët rekord.

Megjithatë, pjesëmarrja e fuqisë punëtore ka vijuar të jetë e ulët deri në krizën COVID-19. Në vitin 2019 qe rritur paksa (0,3 pikë përqindjeje) në 52,7 për qind, një pjesë e së cilës falë hyrjes të më shumë grave në tregun e punës. Përmirësimet kanë ndodhur më së shumti në Shqipëri dhe në Malin e Zi, ku shkalla e pjesëmarrjes është rritur me më shumë se 1 pikë përqindjeje. Por, kur filloi kriza, thuhet një e dyta e popullatës së rajonit në moshë pune qe jo aktive. Në Kosovë, pasiviteti qe rritur madje përpara krizës; 70 për qind të kosovarëve kriza i gjeti pa punë

Figura 1. Shkalla e punësimit u rrit në mbarë rajonin në 2019...

(Shkalla e punësimiti, 15+ vjeç, % dhe diferencë në % për 2018–19)




Figura 3. Shkalla e papunësisë ka arritur nivele të reja të ulëta ...

(Shkalla e papunësisë, 15+ vjeç, % dhe diferenca në pikë përqindjeje 2018–19)

Figura 2. ...dhe krijimi i vendeve të reja të punës u përshpejtua në 3-mujorin IV të vitit 2019.

(Indeksi i punësimit, 3-m II - 2008=100)






Figura 4. ... dhe pjesëmarrja u rrit me hyrjen e më shumë grave në fuqinë punëtore

(Pjesëmarrja në fuqinë punëtore, %, dhjetor 2019 ose më pas)



Burimi: Zyrtar kombëtare të statistikave dhe çmuarje të personelit të Bankës Botërore.

Hendeku gjinor në pjesëmarrjen në krahun e punës është ngushtuar më tej në vitin 2019. Shkalla e pjesëmarrjes së femrave është rritur me 1,4 pikë përqindjeje në mbi 42 për qind, megjithëse ka dallime midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në punën për përfshirjen gjinore ka udhëhequr Shqipëria: shkalla e pjesëmarrjes së femrave në këtë vend ka arritur një nivel të ri të lartë prej 53,3 për qind. Pasonte Mali i Zi me afro 50 për qind, ndërkohë që po hiqen gradualisht pagesat për nënat e reja pa kohëzgjatje të kufizuar. Megjithëse Kosova është ende shumë mbropa, sukseset e parë e kanë rritur shkallën e pjesëmarrjes së femrave në mbi 22 për qind të grave në moshë pune. Në rajonin në tërësi, hendeku në pjesëmarrje midis meshkujve dhe femrave është ngushtuar nga afro 19 pikë përqindjeje në 2018 në 17,4 pikë përqindjeje, por kjo ka ndodhur edhe për shkak të faktit se shkalla e pjesëmarrjes së meshkujve ka rënë në të gjitha vendet me përjashtim të Shqipërisë dhe të Serbisë.

Krizë COVID-19 ka fshirë tashmë një pjesë të arritjeve në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor.

Tkurrja e punësimit në Ballkanin Perëndimor është tashmë e dukshme. Të dhënat për ecurinë e tregut të punës deri në muajin prill tregojnë se rritja më e madhe vjetore e numrit të personave të papunë deri tani në vitin 2020 ka ndodhur në Shqipëri, rritur me 25 për qind, dhe në Maqedoninë e Veriut, me 11 për qind.³ Kjo pasqyron pjesërisht futjen në rregulla të punonjësve joformalë të cilët janë regjistruar për të përfituar nga sigurimet shëndetësore dhe nga pagesa të tjera sociale. Me përjashtim të Serbisë dhe të Kosovës,⁴ të dhënat administrative për papunësinë kanë filluar të tregojnë një rritje vjetore të numrit të personave të papunë. Pas muajit janar ka pasur rreth 63.000 persona të regjistruar rishtazi pranë zyrave të punësimit. Gjithashtu, në tremujorin e parë të vitit 2020, të dhënat për vendet e lira të punës për Malin e Zi tregojnë një rënie prej 75 për qind dhe për Serbinë një rënie prej 48 për qind, çka tregon një përkeqësim të mëtejshëm të situatës në tregun e punës në të ardhmen.

Shoqëritë tregtare kanë kaluar me shpejtësi drejt masave mbrojtëse: kanë ndryshuar orarin e punës, kanë bërë shkurtime të përkohshme të orëve të punës, kanë detyruar punonjësit të marrin lejen vjetore, leje pa të drejtë roge dhe ka pasur edhe shkurtime të vendeve të punës për të përballuar rënien e operacioneve apo madje edhe mbylljen e detyruar.⁵ Sipas Dhomës Serbe të Tregtisë, deri më 31 mars,

³ Në Maqedoninë e Veriut, firmave u është lejuar të rimarrin punonjës në punë dhe të paraqesin kërkesë për subvencione pagash për muajin prill dhe maj, çka me gjasë do të sjellë një korrigjim rënës të numrit të të papunëve.

⁴ Në Kosovë, firmat kanë regjistruar një numër shumë më të lartë punonjësish si rishtazi të papunë, çka tregon se mbështetja për punësim e cila u është dhënë punonjësve të sektorit formal në kuadër të paketës fiskale të qeverisë për situatën e jashtëzakonshme ka kontribuar në formalizimin e punëmarrësve.

⁵ Sipas anketës së kryer në mes të muajit prill nga një grupim ekspertësh në fushën e financave në Maqedoninë e Veriut, rreth 43 për qind e bizneseve qenë detyruar të mbylleshin për shkak të masave që ndalonin lëvizjet dhe

rreth 77.000 punëmarrës qenë shtrënguar me forcë të merrnin leje për shkak të pezullimit të prodhimit, ndërsa rreth 1.000 shoqëri i kishin llogaritë e bllokuara për shkak të paaftësisë për të shlyer detyrimet. Të parët që janë pushuar nga puna kanë qenë punonjësit me kontrata me afat. Sipas anketës së Dhomës Ekonomike të Maqedonisë së Veriut, të zhvilluar në fillim të muajit prill, vetëm 19 për qind e firmave i kishin detyruar punonjësit të merrnin leje dhe vetëm 0,8 për qind e firmave kishin pushuar punonjës nga puna. Shumë firma kishin likuiditet të mjaftueshëm për t'i mbrojtur përkohësisht vendet e punës dhe qenë në pritje të shpalljes së mbështetjes nga qeveria në formë subvencionimi të pagave. E megjithatë, rrezikoheshin rreth 29.000 vende pune pasi shumica e bar-restoranteve dhe hoteleve i mbyllën dyert sipas urdhrave zyrtarë për mbyllje. Një shoqatë biznesi në Kosovë konstatoi se 84 për qind e firmave të anketuara ose qenë mbyllur plotësisht, ose punonin me kapacitet të reduktuar ose me orare të reduktuar pune, dhe rreth 29 për qind e kishin ulur numrin e punonjësve.⁶

Papunësia do të preket më tej nga emigrantët e kthyer. Në vitin 2017, në Europë jetonin rreth 3,7 milionë punonjës nga Ballkani Perëndimor.⁷ Duke qenë se tregjet e punës në Europë janë prekur nga masa kufizuese dhe nga një krizës e kërkesës, punonjësit migruer me kontrata afatshkurtra pune kanë qenë ndër të parët të cilëve u janë shkurtuar vendet e punës. Shumë prej tyre kanë vendosur të kthehen në atdhe për të zvogëluar kostot e jetesës në vendet pritëse, ku nuk kanë pasur mundësi përfitimi nga sigurimet shoqërore apo nga pagesa e papunësisë, por ende nuk ka të dhëna zyrtare për këtë. Sikur të kthehen vetëm 10 për qind e tyre, kjo do ta rriste me një të tretën numrin e të papunëve.

Ndikimi total në punësim pritet të jetë i paprecedentë dhe me bazë të gjerë.

Ndryshimet në punësim me gjasë do të intensifikohen, pas njëfarë vonese nga tkurrja ekonomike. Në vitin 2009, duhej të kalonin dy tremujorë përpara se të dukej qartë ndikimi që pati në punësim ngadalësimi. Në krizën e tanishme, ndikimi në punësim ka qenë më i shpejtë si pasojë e bllokimeve, megjithëse njëfarë shtangësie e tregjeve të punës nuk lejonte largim më të shpejtë të fuqisë punëtore. Me gjasë, do të duhet kohë të duket shkalla e këtij ndikimi. Kjo varet nga

- zhvillimi i krizës (rimëkëmbje e formës V në krahasim me rimëkëmbjen e formës L apo U);
- heterogjenia e strukturës ekonomike të çdo vendi dhe ndikimi që do të ketë COVID-19 në disa sektorë specifikë;
- shpejtësia me të cilën u përgjigjen tregjet e punës tendencave ekonomike në ndryshim; dhe
- efektiviteti i masave shtetërore për mbrojtjen e vendeve të punës dhe të firmave (nga qasja “gjithçka që duhet” deri te paketat e synuara dhe të kufizuara nga mundësitë buxhetore).

Sektorët më të prekur nga rënia drastike e produktit janë hoteleri-turizmi dhe shërbimet ushqimore, disa sektorë prodhimi, tregtia me shumicë dhe një pjesë e tregtisë me pakicë dhe pasuritë e paluajtshme dhe aktivitetet e biznesit (Tabela 1). Këta sektorë punësojnë shumë vetë, shpesh punonjës me pagë të ulët dhe nivel të ulët aftësisish, sidomos në rastin e hoteleri-turizmit dhe shërbimeve ushqimore dhe në tregtinë me pakicë. Punonjësit e angazhuar në aktivitetet e konsideruara thelbësore (si shpërndarja e ushqimeve, produktet farmaceutike) e kanë vijuar punën, por përballen me risqe më të mëdha shëndetësore në punë. Sektori i prodhimit do të ketë një ndikim të diferencuar: farmaceutika,

ndërveprimin, ndërsa 40 për qind e bizneseve prisnin një rënie të konsiderueshme të të ardhurave. Veçanërisht i forte ka qenë ndikimi te mikro-bizneset: përqindja e bizneseve të cilat kanë qenë të detyruara të mbylleshin ishte rreth 55 për qind dhe e atyre me mungesa të theksuara në të ardhura rreth 50 për qind.

⁶ Shih edhe dokumentin shoqëruar: “Cenueshmëria nga COVID-19 në Ballkanin Perëndimor: perspektivë në nivelin e firmave”.

⁷ <https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/data/estimates2/estimates19.asp>.

agropërpunimi dhe prodhimi i ushqimeve, një pjesë e industrisë së letrës dhe tekstileve do t'i vijojnë aktivitetet, ndërsa punonjësve në zinxhirët e furnizimit të industrisë automobilistike u është kërkuar të qëndrojnë në shtëpi me ndalimin e prodhimit. Në sektorët e transportit, magazinimit dhe komunikacionit ka pasur disa prej punonjësve të prekur negativisht (për shembull sektori i aviacionit), ndërsa të tjerët kanë qëndruar për të plotësuar kërkesën në tregtinë online. Bujqësia ka mbetur më së shumti e paprekur, me përjashtim të ofertës së kufizuar të lëndëve të importuara dhe faktorëve të prodhimit bujqësor të importuar për shkak të mbylljes së kufijve.

Tabela 1. Sektorët në risk – harta e nxehtësisë

	ALB	BIH	KOS	MKD	MNE	SRB
Arsimi	I ulët					
Shërbimet shëndetësore dhe punës sociale	I ulët					
Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimet shoqërore të detyrueshme	I ulët					
Komunale (ujë, energji, etj.)	I ulët					
Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve	I ulët					
Informacioni dhe komunikacioni	I ulët					
Bujqësia; pylltaria dhe peshkimi	I ulët					
Minierat dhe guroret	I ulët-I mesëm		I ulët-I mesëm			
Transporti; magazinimi dhe komunikacioni	I mesëm-I lartë*					
Prodhimi	I mesëm-I lartë*					
Ndërtimi	I mesëm-I lartë*					
Shërbimet e hotelerisë dhe restorantet	I lartë					
Pasuri të paluajtshme; aktivitetet e shërbimeve mbështetëse dhe administrative	I lartë					
Tregtia e shitjes me shumicë e pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	I lartë					
Arti, argëtimi dhe çlodhja, dhe shërbime të tjera	I lartë					

Burimi: Korrigjuar sipas botimit të dytë të "ILO Monitor": "COVID-19 dhe bota e punës."

Shënim: Harta e nxehtësisë tregon risqet e analizuar të ndikimit të padëshirueshëm në tregun e punës në çdo sektor.


Nga kriza e punës shkaktuar nga COVID-19 do të preken më së shumti punonjësit meshkuj mbi 30 vjeç me arsim të mesëm, të cilët punojnë në NVM me kontrata definitive.

Përdorimi i vlerësimit të risqeve sektoriale mbi të dhënat për fuqinë punëtore të vendeve të Ballkanit Perëndimor tregon se **nga pasoja e COVID-19 do të preken më së shumti punonjësit meshkuj, mbi 30 vjeç, me arsim të mesëm dhe të punësuar në NVM me kontratë definitive.** Rreth dy të tretat e punonjësve që ka mundësi të preken janë punonjës meshkuj, sepse të punësuar ka më shumë meshkuj se femra, por edhe për shkak të llojeve të punëve që kryejnë meshkujt. Në Kosovë, hendeuku gjinor i cili ekzistonte më parë tregon se vetëm 13 për qind e punonjësve të prekur do të jenë femra. Do të jetë e rëndësishme të sigurohet që pabarazitë gjinore të mos zgjerohen gjatë dhe pas pandemisë dhe që arritjet

sa i takon akumulimit të kapitalit njerëzor, fuqizimit ekonomik dhe dëgjimit të zërit dhe forcës për femrat, të akumuluar me aq mundim gjatë dekadave të fundit, të mos kthehen pas. Tri të katërtat e punonjësve që mund të preken janë të grup-moshës 30-64 vjeç. Për rajonin në tërësi, dy të tretat kanë arsim të mesëm, por në Shqipëri ky grup zë më pak se 50 për qind. Rreth 34 për qind e personave të prekur kanë jo më shumë se arsim fillor. Rreth 23 për qind e të gjithë atyre që mund të jenë prekur janë të vetëpunësuar, ndërsa shumica e tyre (tri të katërtat) janë të punësuar në firma me kontratë definitive në NVM (dy të tretat).

Nuk është për t'u habitur që goditjen më të madhe e kanë marrë punëmarrësit e sektorit privat (88 për qind). Vetëm në Kosovë, do të ketë më shumë punonjës të përkohshëm të cilët do ta humbin punën në krahasim me ata që janë në marrëdhënie definitive pune, por kjo ndodh për shkak të strukturës së tregut të punës përpara krizës. Një e dyta e punonjësve të prekur do të jenë në shoqëri të vogla (deri në 10 punonjës), ndërsa vetëm në Maqedoninë e Veriut mbi 38 për qind e punonjësve të prekur do të jenë nga firma të mëdha. Një e treta e të gjithë punonjësve të prekur në Ballkanin Perëndimor punojnë në tregtinë me shumicë dhe atë me pakicë.

Figura 5. Profilet e punonjësve të cilët mund të jenë prekur⁸



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave, çmuarje të stafit të Bankës Botërore

⁸ Llogaritjet janë kryer nga Ana Maria Oviedo (për Shqipërinë), Trang Van Nguyen (për Serbinë dhe për Malin e Zi), Anastasia Terskaya (për Maqedoninë e Veriut), Stefanie Brodmann (për Kosovën), Leonardo Lucchetti me Agjencinë e Statistikave të Bosnjës dhe Hercegovinës (për Bosnjën dhe Hercegovinën).

Shënim: Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) 2017 është përdorur për Maqedoninë e Veriut dhe për Serbinë. AFP 2018 është përdorur për Shqipërinë, për Kosovën dhe për Malin e Zi. Për Bosnjë-Hercegovinën, janë përdorur të dhënat e AFP 2019; llogaritje nga Banka Botërore dhe nga Agjencia e Statistikës e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Shkalla e rritjes së papunësisë varet gjithashtu nga sa efektive janë masat e politikave për rritjen e kërkesës për fuqi punëtore.

Kundërpërgjigjet e menjëhershme të politikave duhet të sigurojnë masa lehtësuese për punonjësit dhe për ndërmarrjet për të mbrojtur mjetet e jetesës dhe bizneset me rentabilitet ekonomik, sidomos në sektorët e goditur më rëndë, duke hedhur kështu themelet për kushtet për një rimëkëmbje të menjëhershme e të pasur me vende pune me t'u vënë nën kontroll pandemia. Burimet publike duhet të përdoren së pari për të siguruar lehtësim të përkohshëm dhe të synuar për sektorët e prekur më rëndë. Përvoja e ngadalësimeve të mëparshme ekonomike ka treguar se subvencionet e pagave mund të ndihmojnë në ruajtjen e vendeve të punës.⁹ Vlerësimet negative të subvencioneve për pagat zakonisht kanë të bëjnë me programe që synojnë personat në pozita të pafavorshme ose nxisin krijimin e vendeve të reja të punës në kohëra ekonomike "normale". Por, që programet e subvencioneve të arrijnë shpejtësinë e duhur mund të dojë kohë. Komunikimi efektiv, dialogu social dhe angazhimi e qarta nga qeveria kanë rëndësi kritike për kufizimin e humbjes së vendeve të punës gjatë krizës.¹⁰

Politikat e mëposhtme afatshkurtra janë përdorur shpesh për të mbrojtur personat e prekur dhe ndihmojnë në ruajtjen e vendeve të punës në bizneset të cilat në kushte të tjera do të ishin rentabël:

- Lehtësimi i punësimit alternativ ose i aftësisë për punësim të personave të mbetur pa punë;
- Ofrimi i mbrojtjes së të ardhurave për ata që humbin vendin e punës dhe mjetin e jetesës;
- Mbrojtja e bizneseve nga falimentimi i menjëhershëm për shkak të tronditjeve të kërkesës, ndërprerjes së zinxhirëve të furnizimit dhe mbylljes ekonomike; dhe
- Mbështetja e mbajtjes së punonjësve në punë nëpërmjet subvencioneve për punësimin.¹¹

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë futur në zbatim masa për t'i nxitur ndërmarrjet të ruajne ose të krijojnë vende pune. Brenda muajit prill 2020, një muaj pas futjes në zbatim të bllokimit dhe masave kufizuese në të gjithë rajonin, të gjitha qeveritë e rajonit kishin miratuar disa programe mbështetjeje për të shpëtuar vendet e punës dhe firmat. Krahas masave të mbrojtjes së shëndetit, lehtësimeve fiskale, skemave të garancive, linjave të subvencionuara të kreditimit dhe masave të asistencës sociale, ka pasur edhe masa për të shpëtuar vendet e punës nëpërmjet kompensimit të pjesshëm ose të plotë të kostove të pagave, si edhe pagesa më të larta të papunësisë me kriteret e lehtësuara përfitimi (Tabela 2) Ndërkohë që janë duke u zbatuar ende masat e shpallura nga qeveritë, është me rëndësi të monitorohen efektet dhe t'u bëhen përshtatje masave sipas nevojës.

⁹ Shih, për shembull Cahuc (2019) për një shqyrtim të skemave afatshkurtra të kompensimit të punës dhe Bruhn (2016) për Meksikën.

¹⁰ Shih dokumentin e mëposhtëm për parimet e ndërtimit të subvencioneve të pagave:

<https://www.jobsanddevelopment.org/wp-content/uploads/2020/05/WB-Design-and-Implementation-Practices-for-Wage-Subsidies-during-COVID-19.pdf>.

¹¹ Shih edhe dokumentet shoqëruese: "Cenueshmëria nga COVID-19 në Ballkanin Perëndimor: perspektiva në nivelin e firmave" dhe "Kundërpërgjigjet e mbrojtjes sociale ndaj krizës së COVID-19 në Ballkanin Perëndimor".

Tabela 2. Programet e mbështetjes për mbrojtjen e tregjeve të punës në Ballkanin Perëndimor

Masat fiskale	Shqipëri	Bosnjë dhe Hercegovinë	Kosovë	Maqedonia e Veriut	Mali i Zi	Serbi
Subvencione/përrjashtim për pagesat e sigurimeve shoqërore		√	√	√	√	√
Subvencione për pagat në sektorin privat			√	√	√	√
Pagesa papunësie me kritere të lehtësuara	√	√	√	√	√	√

Megjithëse pasojat e krizës janë ende duke u shpalosur, mund të shihen që tani disa shenja të ndrojtura lehtësimi në disa vende. Është mirë që autoritetet të mos e largojnë vëmendjen nga sfida të tilla afatgjata si mungesat akute të fuqisë punëtore dhe aftësive dhe produktiviteti i ulët. Vlen të shihen mundësitë e transferimit të operacioneve të bizneseve në vende më të afërta, kalimit me kontratë të shërbimeve te të tretë dhe digjitalizimit. Në periudhën afatgjatë, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të rrisin edhe investimet në aftësi dhe të zgjerojnë mundësitë për zhvillim të aftësive. Për ta ulur rrezikun e automatizimit dhe për ta përmirësuar cilësinë e vendeve të punës, rajoni duhet të rritë investimet në aftësitë themelore dhe në aftësi moderne “të ekonomisë së re”, të tilla si aftësitë në TIK, aftësia për të zgjidhur probleme, kreativiteti, komunikimi dhe aftësia në marrëdhënie me njerëzit, të cilat do t’u japin mundësi punonjësve të tanishëm dhe të ardhshëm të përshtaten me tregjet e punës të cilat janë duke pësuar ndryshime të vullshme.¹²

¹² Banka Botërore dhe wiiw (2020): Tendencat e tregjeve të punës në Ballkanin Perëndimor 2020.